REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 1583/7 Prot. Vlorë më, 27.10.2022

**VENDIM**

**Nr.44, datë 26.10.2022**

**PËR**
**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT PËR RIORGANIZIMIN MBI 20% TE PROGRAMIT TE CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, "MASTER PROFESIONAL NE MESUESI PER ARSIMIN FILLOR KL.I-V", PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024.**

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, nenit 38, pika 1 shkronja dh, nenit 75, të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma ë, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", si dhe Udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e imstitucionit të arsimit të lartë", si dhe referuar shkresës nr.1424/2 prot, datë 20.10.2022 të Zëvendësrektorit Akademik, Senati Akademik në mbledhjen e datës 26.10.2022

**VENDOSI:**

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Edukimit, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë për miratimin e ndryshimeve për riorganizimin mbi 20%, të programit të ciklit të dytë të studimit "Master Profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor KL. I-V", për vitin akademik 2023-2024.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zv/Rektori Akademik, Drejtuesit e Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë dhe Drejtoria e Edukimit për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve.
3. Bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi shkresa nr.1424/2 prot, datë 20.10.2022.
4. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Admministrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**Prof. As. Xhiliola AGARAJ (SHEHU)**

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E S
UNN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**ZV/REKTORI AKADEMIK**

Nr. 1424/2 Prot. Vlorë më, 20.10.2022

**LËNDA:** PËRCILLEN PER MIRATIM PROPOZIMET E DEPARTAMENTIT TË EDUKIMIT NË FSHHD PËR RIORGANIZIMIN MBI 20% NË PROGRAMIT TE CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, MASTER PROFESIONAL NE MESUESI PER ARSIMIN FILLOR KL.I-V, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024.

**PROF. DR.ROLAND ZISI**
**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

KËTU:

Bazuar në shkresen e Departamentit të Edukimit, në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë, me Nr.1424 prot datë 07.10.2022 ,ne Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në nstitucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"dhe VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 (i ndryshuar) "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit te lartë", përcjellim propozimin per riorganizimin e programit te studimit te Ciklit te dyte te studimeve **Master Profesional ne Mesuesi per Arsimin fillor Kl.I-V,** si më poshtë:

Riorganizim i programit behet per efekt te Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",neni 83 ,i cili orienton qe studimet e ciklit te dyte ne mesuesi te riorganizohen ne studime me 120 kredite.

Bashkelidhur kesaj shkrese:

1. Relacioni i Drejtorise se Edukimit per Ciklin I dhe II te Studimeve ,mbi analizen e riorganizimit.
2. Shkresa e Departamentit të Edukimit, në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë, me Nr.1424 prot datë 07.10.2022 per riorganizimin e programit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**ZV/REKTORI**
**Prof.As.Frosina Londo Qyrdeti**

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E EDUKIMIT PER CIKLIN I DHE II TE STUDIMEVE

Nr. 1424/1 Prot. Vlorë më, 12 . 10 .2022

**LËNDA:** RELACION MBI PROPOZIMET E DEPARTAMENTIT TË EDUKIMIT NË FSHHD PËR RIORGANIZIMIN MBI 20% TË PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, "MASTER PROFESIONAL NË MËSUESI PËR ARSIMIN FILLOR KL.I-V", PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024.

PROF. AS.FROSINA LONDO
ZV/REKTOR AKADEMIK

KËTU:

Bazuar në shkresen Fakultetit te Shkencave Humane dhe Drejtësisë, me Nr.1424 prot datë 07.10.2022 "Percjellje e aplikimit per riorganizim te programit "Master profesional ne mesuesi per Arsimin fillor Kl.I-V"Departamenti i Edukimit ,ne Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në nstitucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"dhe VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 (i ndryshuar) "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit te lartë", përcjellim relacionin mbi ndryshimet e propozuara ne programin e studimit te Ciklit te dyte te studimeve **Master Profesional ne Mesuesi per Arsimin fillor Kl.I-V,** si më poshtë:

Programi ka filluar ne vitin akademik 2012 ne Departamentin e Edukimit ne Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtesise ne UV me 145 studentet e pare nga te cilet 139 ishin femra.

Jane diplomuar deri ne vitin 2021 gjithsej 728 studente nga te cilet 702 femra.

Ky program synon përgatitjen e mësuesve specialistë të arsimit fillor në mësimdhënie, mësimnxënie, vlerësim, përgatitje të aftësive komunikuese me gojë dhe me shkrim. Programi merr përsipër të rrisë aftësinë e studentëve për të menduar objektivisht dhe në mënyrë kritike, për të inkurajuar intelektin dhe stimuluar dëshirën për dije, për të rritur aftësinë, për të

identifikuar, marrë, organizuar, interpretuar, vlerësuar dhe krijuar mbi bazën e të dhënave produkte të vlefshme për mësimdhënien, mësimnxënien, të zhvillojnë aftësitë efektive të komunikimit me gojë dhe me shkrim.Programi synon të përgatisë mësimdhënës të specializuar, të aftë që të punojnë në Arsimin Fillor, në sektorin publik dhe privat duke ju përgjigjur kërkesave të sotme të shkollës.

Ne vitin 2019 ne perputhje me Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" ky program u riorganizuar duke kaluar nga 90 kredite ne 60 kredite deri ne riorganizimin e metejshem.

Ligji nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",neni 83 ,orienton qe studimet e ciklit te dyte ne mesuesi te riorganizohen ne studime me 120 kredite.

Ne zbatim te sa me sipeı si dhe bazuar ne pershtatjen e programit akademik me "Standartet e profesionale te formimit te pergjithshem dhe lendor te mesuesit ne sistemin arsimor parauniversitar ne Shqiperi"te miratuara nga MAS ne vitin 2020 si dhe ne pershtatje me VKM nr 41 date 24.01.2018 (i ndryshuar) " Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit te lartë " departamenti paraqet riorganizimin e programit akademik duke kaluar nga **60 ne 120 kredite.**

Nga analiza e struktures se lendeve ne planin e ri mesimor(120 kredite) ne perputhje me VKM nr.41 date 24.01.2018 verehet se :

| | | |
|---|---|---|
| Lendet baze : | 12 kredite ( 10% ) | - Norma ( 5-10% ) |
| Lendet karakterizuese : | 48 kredite ( 40% ) | - Norma ( 30-40%) |
| Lendet me zgjedhje dhe lendet nderdisiplinore : | 34 kredite ( 28.3% ) | - Norma (30-40%) |
| Lendet plotesuese: | 12 kredite ( 10% ) | - Norma ( 10% ) |
| Detyrime : | 14 kredite ( 11.7% ) | - Norma (10-20%) |

| ***PLANI AKTUAL*** | | | ***PLANI I RIORGANIZUAR*** | |
|---|---|---|---|---|
| **L.Baze** | *Bazat e kultures se* | 6 kredite | *Bazat e kultures se* | *6 kredite* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *edukimit* | | *edukimit* | |
| | | | *Menaxhim i klases* | *6 kredite* |
| **L.karakterizuese** | *Bazat pedagogjike te edukimit* | 6 kredite | *Bazat pedagogjike te edukimit* | *8 kredite* |
| | | | *Bazat psikologjike te edukimit* | *8 kredite* |
| | *Bazat psikologjike te edukimit* | 6 kredite | *Psikologji shkollore* | *8 kredite* |
| | *Kerkim shkencor* | 6 kredite | *Kerkim shkencor* | *8 kredite* |
| | *Te drejtat e njeriut* | 6 kredite | *Mesimdhenie ne gjuhe-letersi* | *8 kredite* |
| | | | *Pedagogji muzikore* | *8 kredite* |
| **L.Nderdisiplinore** | *Komunikimi ne klase* | 6 kredite | *Komunikimi ne klase* | *8 kredite* |
| | | | *Vleresimi i nxenesit* | *8 kredite* |
| | *Shkenca te natyres* | 6 kredite | *Shkrim akademik* | *4 kredite* |
| | | | *Ed,te drejtave te njeriut* | *6 kredite* |
| **L.Me zgjedhje** | *Gjuhe-letersi/* | 4 kredite | *Mesimdhenie ne shkencat e natyres* | *8 kredite* |
| | *Histori-Gjeografi* | | *Mesimdhenie ne Histori-gjeografi* | |
| **L.Plotesuese** | *Gjuhe e huaj* | 4 kredite | *Gj.Huaj.Informatike* | *6 kredite* |
| | | | *Praktika profesionale* | *6 kredite* |
| **Detyrime** | *Provim* | 10 kredite | *Provim/Diplome* | *14 kredite* |
| | | ***60 kredite*** | | ***120 kredite*** |

**I-Ne zbatim te Ligjit te Arsimit te larte 80/2015,neni 83,pika 3 ku theksohet se "Programet e ciklit të dytë të studimit në fushën e mësuesisë duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik"** :

*Programi realizon kete strukture duke planifikuar ne formimin e pergjithshem psiko-pedagogjik te studentit gjithsej 32 kredite qe perbejne 26% te planit,si me poshte:*

a )Shtohet lende e re "Psikologji shkollore" me 8 kredite ne grupin e lendeve karakterizuese.

b) Shtohet lende e re "Pedagogji muzikore " me 8 kredite ne grupin e lendeve karakterizuese.

c)Lenda ekzistuese " Bazat pedagogjike te edukimit "kalon nga 6 ne 8 kredite ne grupin e lendeve karakterizuese.

d) Lenda ekzistuese " Bazat psikologjike te edukimit" kalon nga 6 ne 8 kredite ne grupin e lendeve karakterizuese.

**II-Eshte patur parasysh qe cdo ndryshim lendesh dhe kreditesh ne planin mesimor te jete ne pershtatje me standartet qe i duhen nje mesuesi te arsimit parashkollor ne punen e tij.**

*1-Standardi " Kurrikula dhe zhvillimi i kompetencave kyç ".*

Ky standart i referohet njohurive që ka mësuesi për dokumentet kurrikulare në nivel qendror (korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë, programet lëndore), zbërthimit të këtyre dokumenteve në bazë shkolle dhe planifikimit të tyre sipas nevojave dhe interesave të nxënësve.

*Riorganizimi : Shtohet lenda e re "Shkrim akademik "me 4 kredite te lendet nderdisiplinore.*

*2-Standarti "Mësimdhënia, të nxënit dhe gjithëpërfshirja".*

Ky standard trajton në mënyrë të posaçme përkujdesjen që mësuesi duhet të ketë për suksesin e çdo nxënësi, sidomos për nxënësit me nevoja të veçanta.

*Riorganizimi:a)Shtohet lenda e re "Menaxhim i klases " me 6 kredite ne lendet baze.*

*b)Lenda ekzistuese "Komunikimi ne klase" kalon nga 6 ne 8 kredite.*

*3-Standarti "Vlerësimi i të nxënit".*

Qëllimi i vlerësimit të nxënësit ,për të nxënë, nuk është thjesht nota dhe nuk përfundon shpesh me notë, por synon përmirësimin e të nxënit.

*Riorganizimi: a)Shtohet lenda e re "Vleresimi i nxenesit" me 8 kredite ne lendet nderdisiplinore*

*4-Standarti "Zhvillimi profesional dhe personal i mesuesit".*

Një mësues cilësor është në përmirësim të pareshtur, në sajë të reflektimit ndaj përvojës së tij të përditshme, përvojave të kolegëve të tij dhe qëmtimit në literaturën profesionale.

*Riorganizimi: a)Lenda ekzistuese "Kerkimi shkencor" kalon nga 6 ne 8 kredite.*

*b)Lenda ekzistuese "Mesimdhenie e gjuhes dhe letersise" kalon nga lende me zgjedhje ne lende karakterizuese.*

*c)Shtohet lenda e re " Informatika" me 6 kredite ne lende me zgjedhje.*

*d)Lenda ekzistuese "Gjuhe e huaj" kalon nga 4 ne 6 kredite.*

**III.Gjithashtu ne zbatim te VKM-se nr.41 date 24.01.2018 jane bere ndryshimet:**

Riorganizimi:a)Shtohet lende e re "Praktika profesionale" me 6 kredite ne lendet plotesuse.

b)Detyrimet permbyllese kalojne nga 10 ne 14 kredite.

Bashkelidhur shkresa e Fakultetit te Shkencave Humane dhe Drejtësisë, me Nr.1424 prot datë 07.10.2022 e sipercituar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Drejtore e Edukimit**
**Alberta Breshanaj**

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORË
ZYRA E PROTOKOLL - ARKIVËS
NR. 1424 PROT.
DATA 07.10.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE**
**DEKANI**

Nr. 475/2 prot.

Vlorë, më 07.10 2021

Lënda: Përcjellje e aplikimit për riorganizim të programit të studimit "Master profesional në mësuesi për arsimin fillor klasa I-V", Departamenti i Edukimit

**PROF. DR. ROLAND ZISIT, REKTOR I UV-së**

**Këtu**

I nderuar Z. Rektor,

Në zbatim të shkresës së MAS me nr. 5183/2 prot., datë 12.09.2022 "Për riorganizimin sipas ligjit të një programi të ciklit të dytë në fushën e mësuesisë", përcjellim bashkëlidhur aplikimin e Departamentit të Edukimit për riorganizim të programit të studimit "Master profesional në mësuesi për arsimin fillor klasa I-V", nga 60 kredite në 120 kredite.
Nevojitet vendimmarrje e Bordit të Administrimit për këtë program studimi, i cili është miratuar me vendim të Senatit Akademik nr. 20, datë 30.09.2021, si dhe vendimmarrje nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit për tarifën e studimit të propozuar nga njësia bazë.
Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

**DEKAN**
**Prof. As. Dr. Armela Panajoti**

VLORË

Adresa /Adress: L. Hajrro Cakërri, Rr. Sulejman Delvina, Vlorë, Albania
Tel. Fax ++35533224952
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJËSISË**
**DEPARTAMENTI I EDUKIMIT**

Nr.1175/1 Prot

Vlorë, më 07.10.2022

**Lënda:** Për riorganizimin e programit Master Profesional në "Mësuesi për Arsimin Fillor Klasa 1-V", Departamenti Edukimit

**DEKANIT PROF.ASOC.ARMELA PANAJOTI**

**Fakultetit të Shkencave Humane, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë**

Në përgjigje të shkresës Nr 5183/2, datë 12.09.2022 të MAS "Për riorganizimin sipas ligjit të një programi të ciklit të dytë të studimit në fushën e mësuesisë", me qëllim aplikimin brenda afateve të udhëzimit Nr 20, datë 30.09.2021, për riorganizimin e programit të studimit Master Profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor Klasa 1-V" nga 60 në 120 kredite, përcjellim bashkëlidhur formularin e aplikimit, relacionin shpjegues të grupit të punës ku pasqyrohen ndryshimet nga plani i vjetër.

Programi ka marre miratimin e Senatit Akademik me vendim Nr30, datë 27.07.2022. Kërkojmë miratimin e mëtejshëm nga Bordi i Administrimit. Gjithashtu percjellim për miratim nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit tarifën e studimit. Tarifa e propozuar është 120.000(njëqind e njëzet mijë)lekë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PHD Ilva Lamaj**

**Drejtues i departamentit**

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË**
**DEPARTAMENTI I EDUKIMIT**

Nr.2175 Prot. Vlorë, më 07/10/2022

**Lënda:** Për riorganizimin e programit të studimit "Master Profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor Klasa I-V"

PhD.Ilva Lamaj: Përgjegjësi i Departamentit të Edukimit PhD.Ilva Lamaj

Referuar Ligjit Nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Neni 75, pika 6, pas daljes së akteve nënligjore, Udhëzimit Nr. 31, datë 29.12.2017 "*Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë*", Kreu 3, pika 2-f, si dhe Vendimittë Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018 "*Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara nga Intitucionet e Arsimit të Lartë*" , shtojca Nr. 1.

Në kuadër të vendimit të mbledhjes me datë 06.09.2022 në Departamentin e Edukimit, për riorganizimin e programit të studimit "Master Profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor Klasa I-V"pas punës së zhvilluar, komisioni rezultoi në ndryshimet, si më poshtë:

1. ***EDU 455*** *Manxhimi i klasës (6 kredite) është shtuar si lëndë e re*
2. ***EDU 465*** *Psikologji shkollore(8 kredite)është shtuar si lëndë e re*
3. ***EDU 445*** *Pedagogji muzikore (8 kredite)është shtuar si lëndë e re*
4. ***EDU 450*** *Vleresimi i të nxënit (8 kredite)është shtuar si lëndë e re*
5. ***ALB 577*** *Shkrim Akademik(4 kredite)është shtuar si lëndë e re*
6. ***EDU 475*** *Praktike profesionale (6 kredite)është shtuar si lëndë e re*
7. ***BIO 510*** *Mesimdhenia e Shkencave te Natyres nga (10 kredite) behet me (8 kredite) dhe kalon lende me zgjedhje.*
8. ***EDU 470*** *. Kerkim shkencor ne shkencat e edukimitnga (10 kredite) behet me (8 kredite)*
9. ***EDU 440*** *Edukimi i te drejtave te njeriutnga (10 kredite) behet me (8 kredite)*
10. ***EDU 501*** *Mesimdhenia e Gjuhes dhe letersise (8 kredite) kalon lëndë e detyruar në vend të **BIO 510** Mesimdhenia e Shkencave te Natyres e cila kalon lëndë me zgjedhje.*
11. ***ALB 501*** *i ndryshohet kodi ne **EDU 501***

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Grupi i punës për riorganizimin e "Master Profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor Klasa I-V"

PhD Ilva Lamaj
Dr. Petrit Taraj
Dr. ErjonaDervishaliaj
Dr. Rudina Alimerko
Dr. Eliona Lici

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË**
**DEPARTAMENTI I EDUKIMIT**

**Relacion shpjegues në lidhje me ndryshimet në programin e studimit "Master Profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor Klasa I-V"**

Ndryshimet e paraqitura këtu vijnë si pasojë e riorganizimit të programeve për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për arsimin e lartë (ligji80/2015)dhe më konkretisht VKM NR.41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, e cila parashikon një organizim të rri të veprimtarive formuesenë programet e studimit, gjë që dikton nevojën për rishikim të planit mësimor aktual, si edhe në mbledhjen e Departamentit të Edukimit me datë 06.09.2022

1. ***EDU 455*** *Manaxhimi i klasës (6 kredite) është shtuar si lëndë e re*
2. ***EDU 465*** *Psikologji shkollore(8 kredite)është shtuar si lëndë e re*
3. ***EDU 445*** *Pedagogji muzikore (8 kredite)është shtuar si lëndë e re*
4. ***EDU 450*** *Vleresimi i të nxënit (8 kredite)është shtuar si lëndë e re*
5. ***ALB 577*** *Shkrim Akademik(4 kredite)është shtuar si lëndë e re*
6. ***EDU 475*** *Praktike profesionale (6 kredite)është shtuar si lëndë e re*
7. ***BIO 510*** *Mesimdhenia e Shkencave te Natyres nga (10 kredite) behet me (8 kredite) dhe kalon lende me zgjedhje.*
8. ***EDU 470*** *. Kerkim shkencor ne shkencat e edukimitnga (10 kredite) behet me (8 kredite)*
9. ***EDU 440*** *Edukimi i te drejtave te njeriutnga (10 kredite) behet me (8 kredite)*
10. ***EDU 501*** *Mesimdhenia e Gjuhes dhe letersise (8 kredite) kalon lëndë e detyruar në vend të* ***BIO 510*** *Mesimdhenia e Shkencave te Natyres e cila kalon lëndë me zgjedhje.*
11. ***ALB 501*** *i ndryshohet kodi ne* ***EDU 501,*** *bazuar ne sygjerimet e procesit te unifikimitte programeve, ne bashkepunimme universitete e tjera qe ofrojne kete program studimi.*

Ndryshimet e bëra vijnë për të sjell përfitime shumë të nevojëshme akademike që studentët kanë për plotësimin e detyrimeve në marrjen e licences së mësuesit dhe për të ushtruar sa më mirë dhe më profesionalisht detyrën e tyre si profesionistë, si edhe për të realizuar ndarjen e disiplinave të programit të udhëzimit nr. 41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë". Programit i shtohen lëndët e mëposhtëme:

A. ***EDU 455*** *Manxhimi i klasës (6 kredite) është shtuar si lëndë e re*
B. ***EDU 465*** *Psikologji shkollore(8 kredite)është shtuar si lëndë e re*
C. ***EDU 445*** *Pedagogji muzikore (8 kredite)është shtuar si lëndë e re*
D. ***EDU 450*** *Vleresimi i të nxënit (8 kredite)është shtuar si lëndë e re*
E. ***ALB 577*** *Shkrim Akademik(4 kredite)është shtuar si lëndë e re*
F. ***EDU 475*** *Praktike profesionale (6 kredite)është shtuar si lëndë e re*
G. ***BIO 510*** *Mesimdhenia e Shkencave te Natyres nga (10 kredite) behet me (8 kredite) dhe kalon lende me zgjedhje.*
H. ***EDU 470*** *. Kerkim shkencor ne shkencat e edukimitnga (10 kredite) behet me (8 kredite)*
I. ***EDU 440*** *Edukimi i te drejtave te njeriutnga (10 kredite) behet me (8 kredite)*

J. ***EDU 501** Mesimdhenia e Gjuhes dhe letersise (8 kredite) kalon lëndë e detyruar në vend të **BIO 510** Mesimdhenia e Shkencave te Natyres e cila kalon lëndë me zgjedhje.*
K. ***ALB 501** i ndryshohet kodi ne **EDU 501***
L. Lëndëbazë (12 kreditë)

HUM 460. Bazat kulturore të Edukimit. 6 kredite
EDU 455 Manxhimi i klasës6 kredite

M. Lëndë karakterizuese të programit (48 Kreditë)

EDU 441 Bazat pedagogjike të edukimit8 kredite
EDU 430 Bazat psikologjike të edukimit8 kredite.
EDU 470. Kerkim shkencor ne shkencat e edukimit 8 kredite
EDU 465 Psikologji shkollore8 kredite
EDU 501 Mesimdhenia e Gjuhes dhe Letersiseë8 kredite
EDU445 Pedagogji muzikore 8 kredite

N. Lëndëndërdisiplinore/integruese (34kreditë)
EDU 440 Edukimi i te drejtave te njeriut6 kredite
EDU 450 Vleresimi i të nxënit 8 kredite
ALB 577 Shkrim Akademik4 kredite
HUM 410 Komunikimi ne klase 8 kredite

*Zgjidh një nga:*
BIO 510 Mësimdhënia e Shkencave të Natyres8 kredite
EDU 425 Mësimdhenia e Historisë dhe Gjeografisë

O. Lëndë plotësuese (për njohjen e gjuhës së huaj dhe praktikë profesionale) (12 kreditë)
EDU 475 Praktike profesionale 6 kredite
ENG 550 Gjuhe e huaj 6 kredite

P. Detyrime përmbyllëse (14 kreditë)

EDU 498 Provim përfundimtar/Punim diplome14 kredite

Totali i kreditëve 120

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

Nr. ............. Prot.

Vlorë, më ___.____.2021

**Programi akademik: "Master Profesional në mësuesi për Arsimin fillor Kl I-V"**

| | |
|---|---|
| **A. LËNDË BAZË** | **6 kredite** |
| HUM 460. Bazat kulturore të Edukimit. | 6 kredite |
| **B. LËNDË KARAKTERIZUESE** | **24 kredite** |
| EDU 441 Bazat pedagogjike të edukimit | 6 kredite |
| EDU 430 . Bazat psikologjike të edukimit | 6 kredite |
| EDU 470. Kerkim Shkencor. | 6 kredite |
| EDU 440 Edukimi i te drejtave te njeriut. | 6 kredite |
| **C. LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE** | **16 kredite** |
| HUM 410 Komunikimi ne klase | 6 kredite |
| BIO 510 Mesimdhenia e Shkencave te natyres. | 6 kredite |
| *Zgjidh një nga:* | |
| Alb 501 Mesimdhenia e Gjuhes dhe letersise4 kredite | |
| EDU 425 Mesimdhenia e Historise dhe Gjeografise | 4 kredite |
| **D. LËNDË PLOTËSUESE –** | **4 kredite** |
| ENG 550 Gjuhe e huaj | 4 kredite |
| **E. DETYRIME PËRMBYLLËSE** | **10 kredite** |
| EDU 498 Provim përfundimtar/Punim diplome | 10 kredite |

RTAMENTIT

**DEKANI**

Prof.as. Armela Panajoti

**REKTORI**

Prof. Dr. Roland Zisi

LORE
SITETI "ISMAIL QEMALI" ... RISË

## Profesional në mësuesi për Arsimin fillor Kl I-V

| Lënda | Kredi | Tot. orë / semestërbrenda&jashtauditorit | Tot. orë / semestër në auditorit | lë |
|---|---|---|---|---|
| Kerkim shkencor ne shkencat e edukimit | 6 | 150 | 60 | |
| Bazatkulturoreteedukimit | 6 | 150 | 60 | |
| Bazatpedagogjiketeedukimit | 6 | 150 | 60 | |
| Bazatpsikologjiketeedukimit | 6 | 150 | 60 | |
| Edukimiitedrejtavetenjeriut ne shkolle | 6 | 150 | 60 | |
| **TOTALI** | 30 | 750 | 300 | 1 |
| Mesimdhenia ne shkencat e natyres | 6 | 150 | 60 | |
| Komunikimi ne Klase | 6 | 150 | 60 | |
| Zgjidhnjenga<br>ALB 501 Mesimdhenia e gjuhesdheletersise/EDU425 Mesimdhenia e historisedhegjeografise | 4 | 100 | 45 | |
| Gjuhe e huaj | 4 | 100 | 45 | |
| Provimformimi/diploma | 10 | 250 | 0 | |
| **TOTALI** | 30 | 750 | 210 | 1 |

**MENTIT**

**DEKANI**

Prof.as. Armela Panajoti

TAMENTIT

**DEKANI**

Prof.as. Armela Panajoti

**REKTORI**

Prof. Dr. Roland Zisi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË**
**DEPARTAMENTI I EDUKIMIT**

## PROJEKT-PROPOZIM PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Master Profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor Klasa I-V

| | |
|---|---|
| 1. **Institucioni/IAL** | Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë<br>ëëë.univlora.edu.al<br>*Fakulteti i Shkencave Humane*<br>*Departamenti i Edukimit* |
| 2. **Aplikimi** | a. Riorganizimi i programit |
| 3. **Emërtimi i programit të propozuar për hapje**<br>a. **Shkruani emrin e plotë të programit** | Master Profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor Klasa I-V |
| 4. **Semestri dhe viti akademik i hapjes** | Viti akademik 2022-2023, semestri "Vjeshtë 2022" |
| 5. **Të dhënat për aktin e akreditimit të IAL dhe/ose njësisë kryesore që ofron programin e studimit.** | Akreditimi i UV:<br>Vendim i ASCAL Nr. 71, dt. 21.09.2017<br>Hapja e FSHH:<br>VKMNr. 822, 5. 12. 2007<br>Vendim Senati AkademikNr. 9/4, datë 6.07.2009<br>Hapja e Master profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor Klasa I-V:<br>MASRurdhër **Nr. 270, datë 10/06/2011** |
| 6. **Vendimi i miratimit nga Senati Akademik** | Vendim Nr. 30, datë 27.07.2022 |
| **Vendimi i miratimit nga Bordi Administrimit** | Vendimi Nr...., dt..... i Bordit të Administrimit të UV |
| 7. **Nëse është një program i përbashkët .....** | - |
| 8. **Programi ofrohet nga/në:** | Departamenti i Edukimit<br>Fakulteti i Shkencave Humane DG<br>Kampusi/godina B |

| | |
|---|---|
| **9. Të dhëna mbi personat e kontaktit përgjegjës për programin e studimit** | Emër, mbiemër: Prof. As. Armela Panajoti<br>Pozicioni në IAL: Dekan i FSHH<br>Tel: +355692384468<br>E-mail: armela.panajoti@univlora.edu.al<br>Emër, mbiemër: Phd. Ilva Lamaj<br>Pozicioni në IAL: Përgjegjëse e Departamentit të Edukimit<br>Tel: 0696970953<br>E-mail: ilva.lamaj@univlora.edu.al |
| **10. Deklaratë e titullarit të IAL për plotësimin e standarteve akademike dhe infrastrukturore.** | Shkresa Nr. |
| 11. Firma (emër / mbiemër) e titullarit të institucionit dhe vula e i institucionit. | |

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË PROPOZUAR PËR HAPJE/RIORGANIZIM

## a) Të dhëna mbi programin e studimit

Përshkrimi i përgjithshëm i programit

**Misioni:**Programi studimor "Master Profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor Klasa I-V"formon profesionistë në mësimdhënie lidhur me misionin madhor të FSHH, që është të rrisë standardet e arsimimit nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe komunikimit. Programi i përgjigjet objektivit strategjik për programe cilësore dhe që lehtësojnë punësimin e studentëve edhe në vendet e BE-së.[1]Mbi të gjitha, përmes ketij programi synohet te arrihen njohuri të plota rreth kontekstit evropian të të mësuarit dhe të nxënit gjatë gjithë jetës; ndjesi të formuar për qytetari evropiane me qëllim për ta vënë këtë në shërbim të formimit të brezave të rinj; shprehi të zbatimit të metodave të reja teknologjike në zhvillimin e kurrikulumit; aftësi për të kryer kërkim në fushën e studimit të kryer.

**Qëllimi:**Ky program synon përgatitjen e mësuesve specialistë të arsimit fillor në mësimdhënie, mësimnxënie, vlerësim, përgatitje të aftësive komunikuese me gojë dhe me shkrim. Programi

[1]"2.3 ofrimit të programeve cilësore studimore, sipas përvojave më të mira të BE-së që do të çojnë në njohjen e diplomave të arsimit të lartë të marra në Shqipëri, si edhe në njohjen e kualifikimeve nga BE-ja që do të bëjnë të mundur punësimin e specialistëve shqiptarë në vendet e BE-së." (Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020), f. 132 https://administrata.al/Documents/strategjia%20doc/1.Strategjia%20Kombëtare%20për%20Zhvillim%20dhe%20Integrim%202015%20%20–%20%202020%20.pdf.)

merr përsipër të rrisë aftësinë e studentëve për të menduar objektivisht dhe në mënyrë kritike, për të inkurajuar intelektin dhe stimuluar dëshirën për dije, për të rritur aftësinë, për të identifikuar, marrë, organizuar, interpretuar, vlerësuar dhe krijuar mbi bazën e të dhënave produkte të vlefshme për mësimdhënien, mësimnxënien, të zhvillojnë aftësitë efektive të komunikimit me gojë dhe me shkrim.Programi synon të përgatisë mësimdhënës të specializuar, të aftë që të punojnë në Arsimin Fillor, në sektorin publik dhe privat duke ju përgjigjur kërkesave të sotme të shkollës.

**Objektivat:**

Programi synon t'i pajisë mësuesit e arsimit fillor me:

- shprehi të qëndrueshme në fushën e mësimdhënies, arsimit e të trajnimit profesional të tyre;
- formim të plotë psiko-pedagogjik;
- formim të plotë e bashkëkohor profesional në metodologjinë e mësimdhënies rreth modeleve të të nxënit;
- njohuri të plota mbi teoritë dhe stilet e të nxënit;
- teoritë dhe modelet e zhvillimit dhe të hartimit të kurrikulave, programeve lëndore dhe planifikimit të mësimit;
- aftësi për të trajtuar çështje konceptuale, procedura dhe modele për zhvillimin dhe hartimin e kurrikulave shkollore, të programeve lëndore dhe të planit të mësimit;
- aftësi për të gjetur forma dhe strategji të reja në praktikën shoqërore për pasurimin e kurrikulumit të elementeve të saj;
- njohuri të plota rreth kontekstit evropian të të mësuarit dhe të nxënit gjatë gjithë jetës;
- ndjesi të formuar për qytetarı evropiane me qëllim për ta vënë këtë në shërbim të formimit të brezave të rinj;
- shprehi të zbatimit të metodave të reja teknologjike në zhvillimin e kurrikulumit;
- aftësi për të kryer kërkim në fushën e studimit të kryer;

| | |
|---|---|
| **Lloji i programit** | Master Profesional |
| **Kohëzgjatja** | 2 vjet |
| **Numri i krediteve** | 120 kredite |
| **Njësia bazë/njësia kryesore ofruese e programit të studimit** | Departamenti i Edukimit / Fakulteti i Shkencave Humane |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË**
**DEPARTAMENTI I EDUKIMIT**

**Justifikimi i bazuar në të dhëna empirike dhe të verifikueshme për nevojën e hapjes/riorganizimit të programit**

Departamenti i Edukimit - FSHH propozon hapjen e Programit "**Master Profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor Klasa I-V**"duke u mbështetur në:

- Ligjin Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 70 / pika 4 "Ciklet dhe programet e studimeve",neni 75, 83.
- Udhëzimin Nr.41, datë 24.01.2018 të MASH "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë".
- Udhëzimin Nr. 31, datë 29.12.2017
- Raporti "Formimi fillestar i mësuesve në institucionet e arsimit të lartë shqiptar" publikuar nga IZHA, tetor 2016.
- Standardet profesionale të mësuesit fillestar, MASR, IZHA, 2016.
- Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe lëndor të mësuesit në arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë, MASR, IZHA, shtator 2016.
- Profili i politikës arsimore gjuhësore 2015-2017.

Propozimi është një zbatim konkret i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 4 (Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe mësim për të gjithë) e OZHQ 8 (Punësim i denjë dhe rritje ekonomike); si edhe detyrave që shtrohen nga Agjensia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zgjerimin e sistemit nëpërmjet zgjerimit të njësive ekzistuese, duke u ofruar mundësi më të mëdha studentëve që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve, e që duan të operojnë në fushën e mësimdhënies, si edhe sigurimit të shumëllojshmërisë së ofertave të formimit, në përputhje me nevojat e zhvillimit perspektiv të vendit.
Duke ndjerë nevojat e tregut të punës për mësimdhënie në sektorin publik dhe atë privat, është e nevojshme riorganizimi i "Master Profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor Klasa I-V".

Gjithashtu, nga interesimi i bërë, së bashku me ZA në Vlorë, vërehet se ka nevojë në mjaft shkolla të rrethit të Vlorës, Orikumit Himarës për mësimdhënës për Arsimin Fillor të cilat në një pjesë mbulohen nga personel mësimor pa arsimin e duhur. Në rrethin e Vlorës përafërsisht 15 mësues[2] dalin në pension në pesë vitet e ardhshme. Edhe pse treguesit e popullsisë janë në rënie grupmosha që arsimohet mban tregues të lartë krahasimisht me grupmoshat e tjera.

Grupmosha e cila ndjek studimet pas nivelit Bachelor (deri 24 vjeç), (pa përjashtuar edhe mbi këtë moshë) mban vendin e dytë me 236.981 banorë, pas grupmoshës 25-29 vjeç me 237.376 banorë gjithsej.[3]

[2]ZA, Vlorë
[3]Instat, Popullsia më 1 Janar 2019, f. 4,5
http://www.instat.gov.al/

Tendencat e ndryshme të popullsisë sipas grupmoshave nënkuptojnë një proces demografik tërritjes së moshës mesatare. Pra pakësim të grupmoshës nën moshën e punës, stabilitet me rënie të ngadaltë për grupmoshën e punës dhe rritje për grupmoshën mbi moshën e punës.

**Analiza SËOT e aplikimit për hapje/organizim programi.**

Për përgatitjen e këtij propozimi, u mor parasysh edhe analiza SËOT e realizuar për të vlerësuar së brendshmi pikat e forta dhe të dobëta dhe së jashtmi mundësitë dhe rreziqet. Të dhënat kyçe që u përdorën për këtë analizë përfshijnë:

1. Dokumentet themelore dhe strategjike të institucionit;
2. Dokumentet strategjike të njësisë propozuese;
3. Struktura e organizimit të institucionit;
4. Burimet njerëzore në dispozicion të programit;
5. Të dhënat e përftuara nga pyetësori me studentët;
6. Të dhëna statistikore;
7. Marrëveshjet e bashkëpunimet në këtë kuadër.

Nga shqyrtimi i dokumenteve dhe informacioneve të mësipërme, dolën në pah pikat e forta dhe mundësitë ku mund të mbështetemi për realizimin e këtij programi, si dhe dobësitë dhe rreziqet e jashtme që do të kërkojnë vëmendje nga ana jonë.

***Pikat e forta***

- Qasje institucionale mbështetëse.

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë synon që përmes aktivitetit të tij akademik dhe shkencor të ofrojë mësimdhënie bashkëkohore dhe formim të specialistëve të lartë.[4]Një nga shtyllat e misionit strategjik te UV-së eshte krijimi i nje profili lider "në zhvillimin e arsimit, shkences, sportit dhe kulturës, zhvillimin territorial ne tërësi". Në planin strategjik për zhvillimin e Departamentit të Edukimit, kjo njësi shpreh për mision të vetin formimin e studentëve me shprehi dhe kompetenca të qëndrueshme "që rrisin dhe nxisin formimin e tyre psiko-pedagogjik, kulturor, letrar, gjuhësor, historik, aftësitë e të menduarit kritik dhe aftësitë për jetën, si dhe angazhimin në kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar".

- Staf i kualifikuar në mbështetje të programit me përvojë të gjatë në mësimdhënie dhe kërkim.
  Në këtë program studimi do të angazhohet staf nga Departamenti i Edukimit, Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, Departamenti i Shkencave Kompjuterike dhe të Natyrës. Stafi që do të angazhohet në program është staf i kualifikuar. Konkretisht, në përbërje të Departamentit të Edukimit janë 1 profesor i asociuar, 18 doktorë shkencash, (Personel Akademik Efektiv). Veprimtaria mësimore/kërkimore e stafit të Departmentit të Edukimit është e organizuar në tre grupe mësimore me karakter kërkimor-

[4]Statuti i UV-së,Neni 3, "Roli dhe misioni", f. 7, pika 2, https://univlora.edu.al/statuti/.

Adresa /Adress: L. "Hajrro Cakërri", Rr. "Sulejman Delvina", Vlorë, Albania
Tel. Fax ++35533224952
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

shkencor. Konkretisht:

a. Grupi mësimor-kërkimor i Metodologjisë së Mësimdhënies (6 anëtarë me kohë të plotë);
b. Grupi mësimor-kërkimor iPsiko-pedagogjisë(6 anëtarë me kohë të plotë);
c. Grupi mësimor-kërkimor i Histori-Gjeografisë (7 anëtarë me kohë të plotë);

- Strukturë efektive e njësisë bazë propozuese.

Departamenti i Edukimit është një nga departamentet më të vjetër (çelur më 1997, Departament i Mësuesisë) në Fakultetin e Shkencave Humane, i cili u krijua nga ish Fakulteti i Edukimit (VKM Nr. 822, dt. 05/12/2007).
http://ëëë.aaal.edu.al/dokumente/IAL_publike/UIQ/VENDIM%20Nr.822,date%205.12.2007.pdf)
Numri i personelit akademik dhe ndihmësakademik, përbërës të njësive të këtij fakulteti, është në përputhje me ligjin nr. 80/2015 dhe Udhëzimin nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë".
Në përbërjen e vet, ky departament ka tre grupe mësimore-kërkimore (shih më sipër).

- Infrastrukturë në dispozicion të programit. Fakulteti i Shkencave Humane ka një infrastrukturë mbështetëse në dispozicion të programit: 19 klasa, nga të cilat 13 me kapacitet për leksione dhe 6 me kapacitet për seminare; 1 bibliotekë ($90m^2$), 1 kënd leximi ($40m^2$), 3 laboratore, zyrë IT, zyrë shërbimesh, zyrë studenti, klinikë ligjore, sekretari mësimore, 1 qendër kërkimore (Studime Albanologjike dhe Ballkanike), 4 zyra përgjegjësish, kryesekretari, zyrë dekani, zyrë për zv/dekanet, zyrë asistent i dekanit, zyra stafi (9). Nga këto mjedise, dy laboratore i përkasin Departamentit të Edukimit.
- Bashkëpunimi i konsoliduar me partnerët /operatorët lokalë për zhvillimin e praktikave mësimore (me ZV- të Vlorë, Fier, Berat, Mallakastër, Skrapar, Lushnjë, Kuçovë etj)
- Komponent i fortë praktika mësimore. Praktika do të jetë veprimtari formuese më vete, ku studenti do të aftësohet për mësimdhënie në klasat 1-Vnë arsimin 9 vjeçar.
- Përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të cilësisë, nëpërmjet dhënies së mendimeve të pavarura dhe konfidenciale, orienton dhe drejton institucionin/njësitë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.
- Ekziston udhëzuesi institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, i cili orienton stafin akademik në procesin e mësimdhënies.
- Menaxhim i mirë i sistemit informativ në regjistrimin e vlerësimeve, rrit transparencën, objektivitetin dhe cilësinë e vlerësimit dhe ruajtjes së informacionit.
- Orientim dhe mbështetje e vazhduar për përfshirjen e studentëve në kërkim shkencor.
- Cilësia e mirë e studentëve në hyrje në vitet e fundit.
- Organizim i programit të studimit është në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe programeve homologe në universitetet më të mira perëndimore të cilat rritin mundësitë e

realizimit të mobilitetit të studentëve e stafit akademik dhe krijon shancet për bashkëpunim me universitete partnere.

- Traditë e gjatë në rrethin e Vlorës në mësimdhënie në ciklin e ulët.

*Dobësitë*

- Plotësim i infrastrukturës mbështetëse për disa disiplina specifike. Parashikohet ngritja e një laboratori të informatikës në Fakultetin e Shkencave Humane.
- Mungesa e bibliotekës online për aksesin në libra, revista dhe periodikë që i përkasin fushës së mësimdhënies, psikologjisë dhe kurrikulës, etj.
- Konkurrenca e lartë, Programi Bachelor për Arsimin Fillor Klasa I-V ofrohet nga disa institucione të arsimit të lartë publik në vend.
- Mungesë e programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja.
- Mungesa e aktiviteteve/shërbimeve ndaj të tretëve në formën e konsulencave për të gjeneruar të ardhura Departamentit të Edukimit/Fakultetit.
- Studime periodike të tregut i orientuar në këndvështrimin e punësimit të studentëve dhe përputhshmërisë së dijeve të fituara në përfundim të ciklit të studimeve me kërkesat e punëdhenësve/ tregut të punës.
- Mungesa e rrjetit Alumni dhe aktiviteteve promovuese të këtij rrjeti në rang fakulteti.
- Mungesë e programeve të përbashkëta me universitete homologe brenda dhe jashtë vendit.

*Mundësitë*

- Kuadri ligjor aktual për arsimin e lartë (ligji nr.80/2015) krijon mundësi për ofrimin e programeve akademike që i përgjigjen nevojave ekonomike, kulturore dhe sociale të qarkutdhe rajonit.
- Pjesëmarrja në projekte evropiane për ngritje kapacitetesh për zhvillim kurrikule. UV merr pjesë aktive në projekte të tilla. Pjesëmarrja në një projekt të tillë do të fuqizonte ofertën akademike të programit dhe stafin akademik përgjegjës.
- Mundësi për realizimin e takimeve, konferencave dhe bashkëpunimeve me universitete brenda vendit që kanë programin e studimit Master Profesional në Mësuesi për ArsiminFillor Klasa I-V me tematikë të dedikuar fushës së pedagogjisë, psikologjisë dhe mësimdhënies etj.
- Organizimi i leksioneve të hapura nga Profesorë të fushës të universiteteve brenda vendit dhe me mbështetjen e UV dhe nga universitetet që kemi bashkëpunime në fushën e mobiliteteve për staf dhe studentë.
- Mundësi në rritje e mbulimit financiar për kërkimin shkencor nga ana e Institucionit, duke ofruar mjete financiare për pjesëmarrje në konferenca dhe botime shkencore të stafit të programit/ departamentit.
- Mundësi në rritje e aplikimeve për realizimin e projekteve dhe shkëmbimit me universitete të tjera jashtë dhe brenda vendit.
- Mundësi në rritje për të përdorur rrjetin e profesionistëve Alumni, të cilët janë të punësuar

| | |
|---|---|
| | Bibliotekës Shkencore është njësi ndihmëse e Universitetit, strukturë ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel institucioni dhe është në vartësi të Rektorit, sipas organigramës, nëpërmjet zv/rektorit akademik dhe ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimnxënies/ mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor dhe/ ose të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë (Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë).<br><br>Numri i vendeve për sallë përkatësisht: Total - 120, Bibloteka A - 60, Bibloteka B - 37, Bibloteka C - 23. Numri i përdoruesve/ frekuentuesve: Total - 80, Bibloteka A - 45, Bibloteka B - 20, Bibloteka C - 15. [Në raportin e vetëvlerësimit të institucionit, kapaciteti i Biblotekës A ishte 70, por këtë vit akademik (2019-2020) në mjediset e Bibliotekës Qendrore (Godina A) u krijua Akriva e Bibliotekës dhe hapësira e vendeve të studimit u ngushtua në 60 kapacitetet 60vende studimi në sallë, që deri më sot e përballon numrin e përdoruesve që frekuentojnë Bibliotekën].<br><br>Koeficienti i shfrytëzueshmërisë, [llogaritur me numrin e përdoruesve të bibliotekës mbi numrin e vendeve në çdo sallë (total bibilotekat)] është afërsisht 0.67 ose 67 % shfryëzohet. Sipërfaqja e bibliotekës A është 252 m². Aty u krijua sipas standardeve dhe në mjedisin e duhur për Arkivin e Bibliotekës. Sipërfaqja e bibliotekës B është 90 m², ndërsa Sipërfaqja e bibliotekës C është 80 m².<br><br>Pasurimi i fondeve të bibliotekës sigurohet përgjithësisht me pasurim korrent dhe më pak me pasurim retrospektiv. Burimet e pasurimit për librin në gjuhën shqipe janë: blerjet me procedurë sipas buxhetit të përcaktuar me preventivat dhe specifikimeve teknike, miratur |

| | |
|---|---|
| | nga S.A dhe B.A. [me tenderim], dhe dhuratat nga institucione shtetërore, organizata jofitimprurëse apo persona privatë, për tekste që paraqesin interes për studentët, pedagogët e stafin. Për librin e huaj nëpërmjet burimeve të ndryshme të pasurimit që gjenden në internet. Një adresë e tillë që është shfrytëzuar është: http://ëëë.amazon.com apo Barnes & Noble company http://.barnesandnoble.com<br><br>Biblioteka funksion me fonde të hapura (salla leximi - të tri bibliotekat) dhe me fonde të mbyllura (biblioteka qendrore).<br><br>Në total, fondi i trashëguar (1994-2016 (me blerje dhe dhurata, shqip dhe në gjuhë të huaj) është: 35. 000 tekste në kopje (copë) për rreth 15.000 tituj, nga të cilat blerje janë 29.730 kopje për 10.883 tituj, përkatësisht në Bibliotekën A - 16.048 kopje për 6.179 tituj, në Bibliotekën B - 13.682 kopje për 4.704 tituj. [Biblioteka C është hapur më 28.03. 2018].<br><br>- Për vitin akademik 2016-2017, (në dhjetor 2017) koleksioni i bibliotekës pasurohet 408 tituj, nga të cilët 231 në gjuhën shqipe dhe 177 në gjuhën angleze me 4160 vëllime në total, nga të cilat 3868 shqip, 291 anglisht dhe 1 në italisht.<br><br>-Për vitin akademik 2017- 2018 koleksioni i bibliotekës pasurohet me 160 tituj, nga të cilët 71 shqip, 89 anglisht, në 3224 vëllime nga të cilët shqip 3120, anglisht 104.<br><br>*Për bibliotekën online dhe atë digjitale*:<br><br>1. Në softin Cobib.al për digjitalizimin e katalogut bibliografik të koleksionit të Bibliotekës përditësojmë tekste dhe artikuj shkencorë si pjesë e rrjetit në sistemin ndërkombëtar Cobis. Net. Studentët kanë kërkuar për materiale/ tekste, artikuj digjitalë |

| | |
|---|---|
| | sipas manualit të librarisë digjjitale, i cili ka shërbyer për të aksesuar shërbimin e librarisë digjitale, duke aksesuar këtë shërbim në linkun: https://ulibrary.rash.al/<br>2. Për Bibliotekën elektronike online është punuar me burimet elektronike për Shqipërinë [(Electronic Resources for Albania (ERA2012 Project)], mbështetur nga IZUM/ Qendra Rajonale për Sistemet e Informimit Bibliotekar dhe Sistemet e Informacionit Kërkimor ëëë.cobis.net; EIFL/ InformacioniElektronik për Biblioteka ëëë.eifl.net dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë/ koordinator për projektin ERA 2012 ëëë.akad.edu.al/era ku studentët dhe pedagogët kishin akses në informacion me tekst të plotë nga ebrary Academic Complete, EBSCO Academic Search Premier, Emerald Management e Journal Collection, Multi-Science Journals Collection, ProQuest Central, Taylor & Francis library dhe shumë më tepër.<br>3. Për digjitalizimin e standardizuar dhe të unifikuar të librit/ tekstit mësimor apo artikujve shkencorë të nevojshëm jemi në proces unifikimi me rrjetin e Bibliotekave Universitare me lider Bibliotekën e Akademisë së Shkencave, me synimin e një plani kombëtar për digjitalizimin e Bibliotekave Universitare dhe atyre të rrjetit, me një politikë kombëtare dhe universitare për digjitalizimin e biblitotekave shkencore si për digjitalizimin e tekstit nga botuesi/ enti botues dhe për tekstin e digjitalizuar nga specialist i Bibliotekës.<br>https://ulibrary.rash.al/<br>ëëë.cobis.net<br>ëëë.eifl.net |
| **Zyrën për stafin akademik dhe ndihmës akademik** | *Stafi akademik:*<br>▪ 1 zyrë për drejtuesin e departamentit |

| | |
|---|---|
| | ▪ 1 zyrë për stafin akademik<br>*Stafi ndihmës-akademik:*<br>▪ 1 zyrë për sekretarinë mësimore |

**e) Programet e përbashkëta**

| | |
|---|---|
| Burimet financiare | |
| Kontributi i partnerëve | |
| Vënia në dispozicion e burimeve nga partnerët | |
| Administrimi i programit | |
| Lëshimi i diplomës dhe lloji(diplomë e përbashkët/e dyfishtë/ e shumëfishtë) | |
| Të dhëna mbi aktin e themelimit/licencimit të institucionit partner në vendin e origjinës | |
| Të dhëna mbi aktin e akreditimit të institucionit partner ose të programit të studimit | |
| Dokument zyrtar bashkëpunim mes palëve, marrëveshja kuadër | |
| Marrëveshja specifike për programin konkret të studimit | |

**f) Analizë e tregut të punës**

**Ndryshimi dhe avantazhet potenciale të programit të propozuar për hapjen /riorganizim në lidhje me programet e ngjashme të studimit të ofruar nga IAL të tjera.**

Arsyeja kryesore për kryerjen e kësaj analize është mbledhja e të dhëna mbi vlefshmërinë e kësaj diplome në tregun e punës.

Burimi kryesor i të dhënave mbi të cilat është bazuar ky raport, është një pyetësor i organizuar me: ish/studentët e programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin fillor; Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor si edhe të programit Master profesional në Arsimin Fillor I-V; edukatorë të punësuar në institucionet e arsimit parashkollor.

Do te kontaktohen ish studentë dhe studentët aktualë që ndjekin masterin profesional, nëpërmjet emailit, rrjeteve sociale, telefonit dhe drejtpërdrejt, dhe janë pyetur në lidhje me pozicionin e tyre aktual të punësimit, vendin në të cilin gjendeshin dhe jetonin në vitin 2021-2022, si dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë të drejtëpërdrejtë pyetjes se sa të vlefshme e kishin gjetur këtë diplomë të lëshuar nga Departamenti i Edukimit, UV, si dhe se sa e kishin ushtruar profesionin

e mësuesit që nga momenti i përfundimit të studimeve deri në periudhën korrik 2022.

Burim tjetër të dhënash që do përdoret për analizimin e të dhënave në këtë raport, është edhe një bankë të dhënash të mbledhur nga Sektori i Karrierës Akademike, Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore-Sportive,UV (https://univlora.edu.al/alumni/) në të cilën gjenden të dhëna që janë raportuar në mënyrë vullnetare nga një pjesë e ish/studentëve të këtij departamenti ndër vite. Gjatë kësaj analize kemi hasur disa vështirësi, të cilat po i radhisim si më poshtë:

1. Mungesa e një banke të plotë të dhënash për të gjithë studentët e diplomuar ndër vite, nga ana e universitetit apo edhe në nivel kombëtar, të cilave mund t'u referohen zyrtarisht të interesuarit për shkrimin e këtyre raporteve, për burime informacioni të besueshme, të sakta dhe të shpejta.

2. Mungesa e vullnetit të një pjese të të anketuarve për t'iu përgjigjur pyetjeve të sondazhit si dhe për të dhënë informacion mbi pozicionin aktual të punësimit dhe shtetin ku jetonin e punonin në momentin e anketimit.

Këto të dhëna kanë një rëndësi të madhe për Departamentin e Edukimit, pasi në këtë mënyrë ai do të arrijë të vlerësojë jo vetëm vlefshmërinë e diplomave që ai lëshon, por edhe prirjen e tregut të punës si dhe përputhshmërinë midis programeve të ofruara dhe tregut të punës.

Po kështu ato do të identifikojnë prirjet e tregut, por edhe problemet dhe mospërputhmëritë midis njohurive që u jepen studentëve në universitet dhe kërkesave apo etikës së profesionit përkatës në tregun e punës.

- Përmasa (e tregut të synuar)

Në realitetin shqiptar, gjithnjë e në rritje ka shumë nevojë për mësimdhënës të kualifikuar të aftë t'i përgjigjen kërkesave në rritje në fushën e arsimit.

- Kërkesat dhe prirjet e zbatueshmërisë

Qëllimi kryesor i programeve të sotme të studimit është që të afrojnë sa më shumë programet universitare me tregun e punës. Në këtë logjikë, hapja e programeve të tilla ka për qëllim që t'i përgatisë studentët me njohuritë e duhura teorike dhe me aftësitë e duhura praktike në mënyrë që studentët të pajisen që në auditore me kërkesat dhe aftësitë e mësimdhënësve të aftë për tregun e punës dhe profesionin. Kjo është edhe arsyeja pse shumica e lëndëve që janë të përfshira në program synojnë dhe po zbatohen nga një qasje praktike e profesionit pa mbetur thjesht në kuadrin teorik.

- Analiza e konkurrentëve në treg

Institucionet e ndryshme shtetërore apo private të cilat kanë nevojë për mësimdhënës përzgjedhin në bazë të meritës staf të kualifikuar dhe rezultativ në punën e tyre me nxënësit.

-Lidhje të ndryshme me operatorë/rrjetet e Alumnit

Ka një iniciativë të mirë dhe janë bërë përpjekje nga Sektori i Karrierës Akademike, Alumni

dhe Aktiviteteve Kulturore-Sportive, UV për të mbajtur të dhënat e ish-studentëve të diplomuar në këtë universitet, por mund të themi se aktualisht kjo bankë të dhënash mbetet ende modeste dhe lë për të dëshiruar pasi shumë prej të diplomuarve në universitet nuk janë regjistruar në këtë ëebsite dhe si rezultat të dhënat që ajo disponon në këtë pikë janë të paplota dhe jo shumë domethënëse. Duhet punuar më shumë në këtë drejtim pasi të gjithëve ju interesojnë këto të dhëna sasiore për të mirë të studimeve dhe analizave të tregut të punës që kërkohen.

Programi që propozojmë ka këto avantanzhe:

1. Është program i plotë ndërdisiplinor që mundëson formim profesional me njohuri pedagogjike, psikologjike, të shkencave të natyrës, të shkencave humane dhe kërkimit shkencor, etj.
2. Përmban një kurrikul të bazuar në kompetenca (bazë, gjuhësore, profesionale, metodologjike, teknologjike, kulturore, qytetare, shkencore dhe hulumtuese), të rëndësishme për figurën e mësuesit të arsimit fillor. Këtu jemi përpjekur të identifikojmë kompetencat që duhet të zotërojë një mësues në mënyrë që të integrohen në lëndët në këtë program, si dhe të ofrojmë lëndë që zhvillojnë këto kompetenca.
3. Është një program që plotëson diplomimin e plotë që i duhet një studenti. Në Departamentin e Edukimit të Universitetit të Vlorës, studentët që përfundojnë ciklin Bachelor për mësuesi në Arsimin Fillor dhe Arsimin Parashkollor, kanë mundësi të vazhdojnë pa ndërprerje, në një habitat mësimdhënës të njohur dhe cilësor studimet e ciklit Master Profesional në Mësuesi për Arsim Fillor klasa I-V.
4. Është një program i vlerësuar nga studentët si për cilësinë, rëndëinë e diplomës dhe aksesin për të vazhduar një shkollë, jo shumë larg zonës së banimit, duke mundesuar për një pjesë të tyre, punësimin dhe njëkohësisht vazhdimin e studimeve.

Përvoja shumëvjecare e e Departamentit të Edukimin në Universitetin e Vlorës në fushën e mësimdhënies, kapacitetet akademike të UV-së, kërkon formim të plotë filologjik dhe profesional dhe departamenti ynë i ka këto kapacitete, pasi ka staf të kualifikuar, programe të ndryshme e komplementare, të cilat shërbejnë në formimin e kësaj figure profesionale.

Qëllimi kryesor i programeve të sotme të studimit është që të afrojnë sa më shumë programet universitare me tregun e punës. Në këtë logjikë, hapja e programeve të tilla ka për qëllim që t'i përgatisë studentët me njohuritë e duhura teorike dhe me aftësitë e duhura praktike në mënyrë që studentët të pajisen që në auditore me kërkesat dhe aftësitë mësimdhënëse dhe të jenë të aftë për tregun e punës dhe profesionin. Kjo është edhe arsyeja pse shumica e lëndëve që janë të përfshira në program synojnë dhe po zbatohen nga një qasje praktike e profesionit pa mbetur thjesht në kuadrin teorik.

**Trendi vendas dhe rajonal i punësimit në sektorin ku bën pjesë programi i studimit, referuar burimeve zyrtare si INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, organizma**

**ndërkombëtarë, etj.**
Në statistikat e INSTAT "Të regjistruar në arsim"[5], në vitin akademik 2014-2015 studentë të regjistruar në të gjitha degët janë 162.544 studentë, për vitin 2018-2019 ky tregues ka rënie 139.043 studentë. Rënie vihet re edhe në regjistrimet e studentëve në arsimin e lartë sipas fushave të studimit. Në Shkenca Arsimi për vitin akademik 2014-2015 janë regjistruar 13,654 studentë, kurse në vitin akademik 2018-2019 ky tregues është në rënie: në10,062 studentë në vitin 2018-2019, rënie me 3592 studentë. Gjithsesi nëse krahasohet me degët e tjera të studimit për të njëjtën periudhë në shkenca arsimi ka më tepër studentë të regjistruar.[6]

**Nevoja e përmbushur e tregut të punës që plotëson programi i ri/riorganizuar i propozuar nga IAL-ja.**
Siguron një formim mbështetës dhe tëplotë në fushën e arsimit. Ai plotëson nevojën e tregut për programe studimi në fushën e mesuesise. Krijon mësimdhënës të aftë për të shërbyer me cilësi në nivelin e arsimit ciklit të ulët, në arsimin publik dhe atë privat.

**Strukturat në dispozicion të studentëve për të bërë ndërlidhjen me tregun epunës si dhe burimet financiare në dispozicion të këtyre strukturave.**
Struktura në dispozicion të studentëve për të bërë ndërlidhjen me tregun e punës është Drejtoria e Edukimit, Sektori i Këshillimit të Karrierës, Alumnit dhe Aktiviteteve Kulturore-Sportive. Burimet financiare në dispozicion të këtyre strukturave janë të ardhurat e vetë institucionit.

**Punësimi potencial i Studentëve.**
Ky program studimi krijon mundësinë për të punuar në institucione arsimore shtërore e private, të cilët kanë nevojë për mësues të arsimit fillor klasa I-V, të aftë për të realizuar mësimdhënie e mësimnxënie efektive. Këto mund të përfshijnë:

a. Shkolla 9-vjeçare e të mesme shtetërore (publike)

b. Shkolla 9-vjeçare e të mesme private (jo publike)

[5]INSTAT. Tabela 'Të regjistruar në arsim', 2018, http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-punës-dhe-arsimi/të-dhëna-administrative-të-tregut-të-punës/#tab1.
[6]INSTAT, http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-punës-dhe-arsimi/punësimi-dhe-papunësia/tab3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË**
**DEPARTAMENTI I EDUKIMIT**

**Marrëveshje/ kerkesa paraprake nga operatorë privatë/institucione publike për punësim eventual të studentëve pas diplomimit.**

Në mbështetje të realizimit të komponentëve mësimore që ngërthen programi, sidomos komponentin e praktikës, por edhe për të mundësuar punësimin eventual të studentëve pas diplomimit, jane nënshkruar këto marrëveshje nga njësia kryesore:

1. Marrëveshje e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë me DAR , Vlorë (sot ZA)
2. Marrëveshje e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë me Bashkinë Vlorë, që nënkupton përfshirjen e gjithë institucioneve ndërvarëse të saj në fushëveprimin e kësaj marrëveshjeje. (17.06.2019, nr. 775/2 prot.)

**Studimi i tregut do të paraqitet i plotë në një moment të dytë pas përfundimit të punës nga Departament i Edukimit dhe Drejtoria e Edukimit për Ciklin e parë dhe të dytë të Studimit.**

**Referenca**


Këshilli i Ministrave. VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elemente e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë".https://univlora.edu.al/ëp-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë . Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". http://arsimi.gov.al/ëp-content/uploads/2018/08/AKTET_NENLIGJORE.pdf.

INSTAT. Tabela 'Studentë në arsimin e lartë sipas fushave të studimi', http://ëëë.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-punës-dhe-arsimi/arsimi/#tab2.

INSTAT, http://ëëë.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-punës-dhe-arsimi/punësimi-dhe-papunësia/.

MASR. Udhëzimi nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë". https://arsimi.gov.al/udhezim-nr-27-



Adresa /Adress: L. "Hajrro Cakërri", Rr. "Sulejman Delvina", Vlorë, Albania
Tel. Fax ++35533224952

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

date-29-12-2017-per-strukturat-e-brendshme-akademike-dhe-administrative-ne-institucionet-publike-te-arsimit-te-larte-2/.

QZHQ, 4.7., http://ëëë.senior-a.al/docs/17SDGs_Shqip.pdf.

Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020, https://administrata.al/Documents/strategjia%20doc/1.Strategjia%20Kombëtare%20për%20Zhvillim%20dhe%20Integrim%202015%20%20–%20%202020%20.pdf.

MASR. Udhëzimi nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë". http://arsimi.gov.al/udhezim-nr-1-date-14-01-2020-per-dokumentacionin-dhe-procedurat-per-hapjen-riorganizimin-dhe-mbylljen-e-institucionit-te-arsimit-te-larte-degeve-te-tyre-njesive-kryesore-dhe-programeve-te-studimi/.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. *Programi qeverisës 2017-2021*. https://kryeministria.al/ëp-content/uploads/2017/11/PROGRAMI.pdf.

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë. *Statuti*. https://univlora.edu.al/statuti/.

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë. Plani Strategjik i UV-së, 2028-2024, Vendim i Bordit të Administrimit Nr. 26, datë 8.11.2018, https://univlora.edu.al/ëp-content/plugins/ari-fancy-lightbox/assets/pdfjs/ëeb/vieëer.html?file=https%3A%2F%2Funivlora.edu.al%2Fëp-content%2Fuploads%2F2018%2F11%2Fplani_dok_final.pdf#page=1&zoom=auto,-12,529.

Adresa /Adress: L. "Hajrro Cakërri", Rr. "Sulejman Delvina", Vlorë, Albania
Tel. Fax ++35533224952

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

dhe të suksesshëm në punën e tyre, në drejtim të rritjes së promovimit të të diplomuarve në Arsimin Fillor.

- Strategjitë për të tërhequr dhe mbajtur studentët. Vitet e fundit numri i studentëve që regjistrohen në programe studimi në arsimin e lartë ka pësuar rëniepër shkaqe të ndryshme, kryesisht demografike. Kështu, në vitin akademik 2020-2021numri i studentëve ka pësuar ulje me 4.6% në krahasim me vitin 2019-2020, ndërkohë që në vitin akademik 2018-2019 ky numër ishte 139043 në total për të gjitha fushat e studimit në shkallë vendi nga 162544 që ishte në vitin akademik 2014-2015 (Burimi: INSTAT, tabela 'Studentë në arsimin e lartë sipas fushave të studimit, http://ëëë.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-punës-dhe-arsimi/arsimi/). Përveç strategjive promovuese për njësinë dhe programin e studimit në popullatën potenciale për studentë në këtë program studimi, strategji të tjera të brendshme do të ndiqen, si: ulje e kostove të materialeve didaktike, duke përdorur forma alternative pa kosto si depozitimi i materialeve në formë elektronike dhe të vlefshme për studentët e kursit, përdorimi i burimeve të hapura didaktike (open resource), jo vetëm për komponentin e praktikës, por edhe për kurse specifike, program mësimor që përgatit për punësim.

*Rrezige/Kërcënime*

- Konkurrenca në arsimin e lartë. Arsimi i lartë po vjen e po bëhet gjithnjë e më shumë konkurrent. Studentët bëjnë zgjedhjet e tyre bazuar në elemente të ndryshme të ofertës akademike nga institucionet e arsimit të lartë. Kjo kërkon përshtatshmëri nga ana jonë dhe studim të kërkesave të studentëve, si edhe bashkëpunim me punëdhënësit për t'i formuarstudentët me shprehi pune.
- Lëvizjet migratore. Këto mund të sjellin ulje të mëtejshme të popullatës studentore.
- Kjo ulje e numrit të studentëve sjell uljen e të ardhurave financiare për Institucionin, të përftuara nga tarifat e vendosura.
- Ulja e mëtejshme e popullsisë

**b) Të dhëna mbi kriteret e pranimit në këtë program studimi, tarifa dhe modalitetet financiare për studentët.**

| **Kriteret e pranimit në programin e studimit.** |
|---|
| Në këtë program studimi ka të drejtë të aplikoj cdo shtetas shqiptar që ka një diplomë të ciklit të parë në mësuesi në Arsimin Fillor dhe mësuesi në Arsimin Parashkollor ose diploma të ngjashme në degët e tjera të mësuesisë ka të drejtën të aplikojë për t'u pranuar në këtë program.<br>Renditja e kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës bazuar në notën mesatare,në rastin e tejkalimit te kuotave.<br>Për kategori të veçanta, si: personat me aftësi të kufizuar, ndihmë sociale, trojet, romë, egjiptianë, programe të dyta, transferime etj. do të rezervohen kuota të posaçme. |
| **Fusha e studimeve paraardhëse në rastet e programeve të ciklit të dytë.** |

Adresa /Adress: L. "Hajrro Cakërri", Rr. "Sulejman Delvina", Vlorë, Albania
Tel. Fax ++35533224952
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

| |
|---|
| Pedagogji , Psikologji, Shkencat e Natyres,Gjuhësi |
| **Numri maksimal i studentëve që do të pranohen.** |
| 30 studentë |
| **Tarifa e studimit.** |
| 120.000 lekë |
| **Politika e mbështetjes financiare për studentët (llojet e bursave nëse ka).**<br>Bazuar në nenin 73, pika 1, shkronja f, studentët e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë kanë të drejtë "të përfitojnë bursë studimi kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave si dhe shpërblime të veçanta që administrohen nga universiteti". Sipas VKM nr. 903, datë 21.12.2016, ndryshuar me VKM nr. 784, datë 26.12.2018, kategoritë që përfitojnë bursë dhe reduktim të tarifës së studimit. |
| **Kuota të dedikuara për studentë të kategorive të veçanta.** |
| Shqiptarë nga trojet – 2 kuota<br>Grupet e margjinalizuara (romë, egjiptianë) – 3 kuota |

**c) Plani mësimor/ Kurrikula e programit të studimit**

| **Numri total i krediteve** | **120 kredite** |
|---|---|
| **Pasqyrë analitike (për lëndë e module) e kurrikulës dhe krediteve si më poshtë:** | |
| **Kategoria A. Lëndë Bazë: përgatitjemetodologjike dhe kulturë epërgjithshme (12kredite)** | |
| **HUM 460** - Bazat kulturore të Edukimit *6kredite*<br>*Kompetenca(t)/rezultatet e të nxënit të cilës/cilave i/iu përgjigjet: 2.1; 6.1; 7.1.*<br><br>**EDU 455**–Menaxhimi i klasë*6 kredite*<br>*Kompetenca(t)/rezultatet e të nxënit të cilës/cilave i/iu përgjigjet: 2.1; 5.3.* | |
| **Kategoria B. Lëndë Karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore (48 kredite)**<br><br>**EDU 441** –Bazat pedagogjike tëEdukimit*8 kredite*<br>*Kompetenca(t)/rezultatet e të nxënit të cilës/cilave i/iu përgjigjet: 6.3; 8.2.*<br><br>**EDU 430**–Bazat psikologjike të Edukimit*8 kredite*<br>*Kompetenca(t)/rezultatet e të nxënit të cilës/cilave i/iu përgjigjet:2.2; 4.2.* | |

**EDU 470** - Kërkim shkencor në shkencat e Edukimit*8 kredite*
*Kompetenca(t)/rezultatet e të nxënit të cilës/cilave i/iu përgjigjet:4.4; 5.3; 8.1.*

**EDU 465**–Psikologji shkollore *8 kredite*
*Kompetenca(t)/rezultatet e të nxënit të cilës/cilave i/iu përgjigjet:4.2.*

**EDU 501**–Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë *8 kredite*
*Kompetenca(t)/rezultatet e të nxënit të cilës/cilave i/iu përgjigjet: 5.1; 5.2.*

**EDU 445** – Pedagogji muzikore *8 kredite*
*Kompetenca(t)/rezultatet e të nxënit të cilës/cilave i/iu përgjigjet: 7.1.*

**Kategoria C. Lëndë ndërdisiplinore/integruese – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje**

**(34 kredite)**

**EDU 440** – Edukimi i të drejtave të njeriut*6 kredite*
*Kompetenca(t)/rezultatet e të nxënit të cilës/cilave i/iu përgjigjet: 7.4; 8.1.*

**EDU 450** – Vlerësimi i nxënësit*8 kredite*
*Kompetenca(t)/rezultatet e të nxënit të cilës/cilave i/iu përgjigjet: 4.3.*

**ALB 577**–Shkrim Akademik*4 kredite*
*Kompetenca(t)/rezultatet e të nxënit të cilës/cilave i/iu përgjigjet: 4.1.*

**HUM 410** – Komunikimi në klasë *8 kredite*
*Kompetenca(t)/rezultatet e të nxënit të cilës/cilave i/iu përgjigjet:* 2.1; 7.1.

Zgjidh një nga:

**BIO 510** – Mësimdhënia e Shkencave të Natyrës

**EDU 425** – Mësimdhënia e Historisë dhe Gjeografisë *8 kredite*
*Kompetenca(t)/rezultatet e të nxënit të cilës/cilave i/iu përgjigjet: 5.1.*

**Kategoria D. Lëndë plotësuese-gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale**
**(12 kredite)**

**EDU 475** – Praktikë profesionale*6 kredite*
*Kompetenca(t)/rezultatet e të nxënit të cilës/cilave i/iu përgjigjet: 5.1.*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

**ENG 550** – Gjuhë e huaj *6 kredite*
*Kompetenca(t)/rezultatet e të nxënit të cilës/cilave i/iu përgjigjet: 6.2.*

**Kategoria E. Detyrime përmbyllëse**

**EDU 498** - Provim përfundimtar/Punim diplome*14 kredite* **(14 kredite)**
*Kompetenca(t)/rezultatet e të nxënit të cilës/cilave i/iu përgjigjet:* Të gjitha

**Plani mësimor me përbërësit specifikë sipas kuadrit ligjor në fuqi.**

**Plani mësimor "Master profesional në mësuesi për Arsimin fillor I-V"**

| Viti | Semestri | Kodi | Lënda | Kredite | Tot. orë / semestër brenda & jasht auditorit | Tot. orë / semestër në auditorit | Totali orë / javë në auditorit | | Totali orë jashtë auditorit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | lek | sem | Detyra |
| Viti 1 | Semestri 1 | EDU 410 | Komunikimi ne klase | 8 | 200 | 75 | 3 | 2 | 125 |
| | | HUM 460 | Bazat kulturore te edukimit | 6 | 150 | 60 | 2 | 2 | 90 |
| | | EDU 441 | Bazat pedagogjike te edukimit | 8 | 200 | 75 | 3 | 2 | 125 |
| | | EDU 430 | Bazat psikologjike te edukimit | 8 | 200 | 75 | 3 | 2 | 125 |
| | | | TOTALI | 30 | 750 | 285 | 11 | 8 | 465 |
| | Semestri 2 | EDU 501 | Mesimdhenia e gjuhes dhe letersisë | 8 | 200 | 75 | 3 | 2 | 125 |
| | | EDU 470 | Kerkim shkencor ne shkencat e edukimit | 8 | 200 | 75 | 3 | 2 | 125 |
| | | EDU 450 | Vleresimi i nxenesit | 8 | 200 | 75 | 3 | 2 | 125 |
| | | EDU 455 | Manxhimi i klasës | 6 | 150 | 60 | 3 | 1 | 90 |
| | | | TOTALI | 30 | 750 | 285 | 12 | 7 | 465 |
| Viti 2 | Semestri 3 | ALB 577 | Shkrim Akademik | 4 | 100 | 45 | 2 | 1 | 55 |
| | | EDU 465 | Psikologji shkollore | 8 | 200 | 75 | 3 | 2 | 125 |
| | | EDU445 | Pedagogji muzikore | 8 | 200 | 75 | 3 | 2 | 125 |
| | | BIO 510 / EDU425 | Zgjidh nje nga<br>BIO 510 Mesimdhenia ne shkencat e natyrës<br>e/EDU425 Mesimdhenia e historise dhe gjeografise | 8 | 200 | 75 | 3 | 2 | 125 |
| | | | TOTALI | 28 | 700 | 270 | 11 | 7 | 430 |
| | | EDU 440 | Edukimi i te drejtave te njeriut | 6 | 150 | 60 | 2 | 2 | 90 |
| | | ENG 550 | Gjuhe e huaj | 6 | 150 | 60 | 2 | 2 | 90 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | EDU 475 | Praktikë profesionale | 6 | 150 | 0 | 0 | 0 | 150 |
| | EDU 498 | Provim përfundimtar/Punim diplome | 14 | 350 | 0 | 0 | 0 | 350 |
| | | TOTALI | 32 | 800 | 120 | 4 | 4 | 680 |

**c) Personeli akademik dhe ndihmës akademik**

| | |
|---|---|
| **Numri i personelit akademik në njësinë bazë** | 19 pedagogë me kohë të plotë |
| **Numri i personelit akademik që i dedikohet programit të studimit (personel me kohë të plotë/pjesshëm )** | 13 pedagogë me kohë të plotë |
| **Numri i personelit akademik të përfshirë përgjegjës për lëndët karakterizuese (personel me kohë të plotë/pjesshëm)** | 6 pedagogë |
| **CV e shkurtuara të personelit akademik që do të angazhohet në program (titulli/grada, fusha e ekspertizës kërkimore),** | **Ilva Lamaj**<br>*Kategoria:* Profesor<br>*Grada shkencore:* PHD<br>*Fusha e ekspertizës:*<br>Psikologji/Komunikimi në Klasë<br>Ngrkesa HUM410 (75ore) |
| | **Petrit Taraj**<br>*Kategoria:* Lektor<br>*Grada shkencore:* Doktor Shkencash<br>*Fusha e ekspertizës:*<br>Pedagogji/ Bazat pedagogjike të Edukimit<br>Ngarkesa: EDU440(75ore) |
| | **Aranit Gjipali**<br>*Kategoria:* Lektor<br>*Grada shkencore:* Doktor Shkencash<br>*Fusha e ekspertizës:*<br>Pedagogji/ Kërkim shkencor në fushën e edukimit /Menaxhimi i klases<br>Ngarkesa: Edu455 (60ore)+EDU470(75ore) |
| | **Rudina Alimerko**<br>*Kategoria:* Lektore<br>*Grada shkencore:* Doktore Shkencash |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

| | |
|---|---|
| | *Fusha e ekspertizës:*<br>Letërsi/Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë<br>Ngarkesa:EDU501(75ore) |
| | **Eliona Lici**<br>*Kategoria:* Lektore<br>*Grada shkencore:* Doktore Shkencash<br>*Fusha e ekspertizës:*<br>Arte / Pedagogji muzikore<br>Ngarkesa:EDU445(75ore) |
| | **Irena Alimerko**<br>*Kategoria:* Lektore<br>*Grada shkencore:* Doktore shkencash<br>*Fusha e ekspertizës:*Psiko-pedagogji/<br>Psikologji Shkollore<br>Ngarkesa:EDU465(75ore) |
| | **Blerina Xhelaj**<br>*Kategoria:*Lektore<br>*Grada shkencore:* Doktore Shkencash<br>*Fusha e ekspertizës:*<br>Histori/ Edukimi i të drejtave të njeriut<br>Ngarkesa:EDU440(60ore) |
| | **Enkelejda Billa**<br>*Kategoria:* Lektore<br>*Grada shkencore:* Doktore Shkencash<br>*Fusha e ekspertizës:*<br>Histori/ Bazat Kulturore të Edukimit<br>Ngarkesa:HUM460(60 ore) |
| | **Erjona Dervishaliaj**<br>*Kategoria:* Lektore<br>*Grada shkencore:* Doktor Shkencash<br>*Fusha e ekspertizës:*Psikologji/ Bazat psikologjike të Edukimit<br>Ngarkesa:EDU430(75ore) |
| | **Hajdar Kiçaj**<br>*Kategoria:* Lektor<br>*Grada shkencore:* Prof.Asoc<br>*Fusha e ekspertizës:*<br>Bio-Kimi /Mësimdhënia e shkencave të natyrës |

| | |
|---|---|
| | Ngarkesa:BIO510(75ore) |
| | **Fatlinda Shkurti**<br>*Kategoria:* Lektore<br>*Grada shkencore:* Doktore Shkencash<br>*Fusha e ekspertizës:*<br>Gjeografi/ Mësimdhënia e gjeografisë<br>Ngarkesa:EDU425(75ore) |
| | **Doriana Klosi**<br>*Kategoria:* Lektor<br>*Grada shkencore:* Doktor Shkencash<br>*Fusha e ekspertizës:*Gjuhë e huaj/angleze<br>Ngarkesa :ENG550(60ore) |
| | **Asllan Vrapi**<br>*Kategoria:* Lektor<br>*Grada shkencore:* Doktor Shkencash<br>*Fusha e ekspertizës:*Mesimdhenie/ vleresimi i të nxënit<br>Ngarkesa:EDU450(75ore) |
| | **Edlira Cerkezi**<br>*Kategoria:* Lektor<br>*Grada shkencore:* Doktor Shkencash<br>*Fusha e ekspertizës: letersi* /shkrim akademik<br>Ngarkesa:ALB577(45ore) |
| **Numri i personelit ndihmës akademik me karakter mësimor në funksion të programit të studimit.** | 1 staf ndihmës-akademik (sekretare mësimore) |
| **Nëse programi i propozuar është interdisiplinor, identifikoni personelin akademik që vjen nga departemente apo fakultete të tjera** | Hajdar Kicaj, Edlira Cerkezi, Doriana Klosi |

**d) Infrastruktura akademike në funksion të programit**

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË**
**DEPARTAMENTI I EDUKIMIT**

| | |
|---|---|
| **Numrin dhe sipërfaqet e auditorëve** | Fakulteti i Shkencave Humane, godina B, ka një sipërfaqe prej 3040 m2. Për akomodomin e studentëve dhe lehtësim në gjetjen e sallave të lira procesi mësimor është organizuar në dy orare të ndryshme prej orës 14:00 deri në orën 20:00 studentët e ciklit të dytë Master Profesional në Mesuesi per Arsimin Fillor klasa I-V, duke iu krijuar mundësinë, e përdorimit të mjediseve si biblioteka, laboratore, kënd leximi jo vetëm gjatë këtij orari, por edhe më tej. Sipas vendimit Nr. 418, datë 10.05.2017 "Për standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e instituicioneve të arsimit të lartë" Aneksi 1/C për normativat e sipërfaqes së shfrytëzueshme e ndarë sipas fushave të studimit për shkencat humane është 2.5 m2. Klasat në dispozicion të mësimit:<br>Kati i parë:<br>Klasa 101 (70 m2)<br>Klasa 109 (70 m2)<br>Klasa 112 (40 m2)<br>Klasa 111 (40 m2)<br>Klasa 110 (60 m2)<br>Kati i dytë:<br>Klasa 215 (70 m2)<br>Klasa 216 (70 m2)<br>Klasa 217 (50 m2)<br>Klasa 201 (60 m2)<br>Kati i tretë:<br>Klasa 308 (110 m2)<br>Klasa 307 (70 m2)<br>Klasa 305 (70 m2) |

| | |
|---|---|
| | Klasa 304 (40 m2)<br>Klasa 301 (60 m2)<br>Kati i katërt:<br>Klasa 412 (60 m2)<br>Klasa 407 (40 m2)<br>Klasa 409 (110 m2)<br>Klasa 404 (90 m2)<br>Klasa 402 (50 m2)<br>Klasa 401 (60 m2) |
| **Laboratorët dhe mjediset për realizimin e praktikës profesionale.** | Fakulteti i Shkencave Humane zotëron gjithsej 3 laboratorë (edukim, pedagogji, gjuhë e huaj), nga të cilët 2 laboratorë i përkasin Departamentit të Edukimit dhe një Departamentit të Gjuhëve të Huaja. Laboratorët janë të mirëpajisur me materiale didaktike, videoprojektorë dhe kompjutera (i gjuhëve të huaj).<br>Mjedise të tjera në funksion të realizimit të programit janë biblioteka e fakultetit (90m$^2$) dhe këndi i leximit i Departamentit të Gjuhëve të Huaja (40m$^2$). |
| **Bibliotekë, numrin e titujve, numrin e posteve të leximit, e-library** | Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë ka në dispozicion të studentëve, pedagogëve, studiuesve dhe stafit 3 (tre) biblioteka me 3 (tre) salla leximi, me personel 4 (katër) vetë, me vendndodhje, përkatësisht: Biblioteka qendrore, në Godinën A (Rektorati), që mbulon dhe Fakultetin e Ekonomisë me personel 2 (dy) specialistë, Biblioteka B, në Fakultetin e Shkencave Humane me 1 (një) specialist (që mbulon edhe Fakultetin e Shëndetit Publik) dhe Biblioteka e re në godinën C, në Fakultetin e Shkencave Teknike me 1 (një) specialist/e. Sektori i |